



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke u bazuar në kërkesën e Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural nr.01-112/02-8767 të datës 25.02.2025, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM PËR CAKTIMIN E ZYRTARËVE PËRGJEGJËS

I.Me këtë Vendim, caktohen zyrtarët përgjegjës komunalë të cilët do ta ndihmojnë Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari përkitazi me procesin e aplikimit të fermerëve të Komunës së Lipjanit për pagesat direkte në bujqësi, sipas Thirrjes për aplikim për vitin 2025, e cila do të shpallet nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ,në përbërje si vijon:

1. Fatbardha Shurdhiqi, Drejtorati për Infrastrukturë
2. Fitore Buja, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim
3. Arbëresha Hetemi, Zyra Lokale për Komunitete
4. Pranvera Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport

II. Zyrtarët përgjegjës të cekur më lartë brenda periodës sa zgjat Thirrja publike do të jenë të angazhuar dhe do të punojnë sipas udhëzimeve të Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari përmes sistemit përkatës elektronik.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit ndërsa me kopjen e këtij Vendimi do të njoftohen Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari dhe zyrtarët përgjegjës të cekur në pikën I të këtij Vendimi.

1Nr.112/02-8767
Lipjan, 25.02.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, nenit 23 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATAVE TË OJQ-ve PËRFITUESE TË SUBVENCIONEVE PËR VITIN 2025

Neni 1

Me këtë Vendim, **Lorik Berbatovci**, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** Zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratave të OJQ-ve përfituese të subvencioneve për vitin 2025 për thirrjen publike Nr.5-453/01-60170 të datës 06.12.2024, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sportë.

Zyrtari përgjegjës do të bëjë monitorimin e zbatimit të kontratave të OJQ-ve si vijon :

Nr.	Emërtimi i OJQ-ve
1.	Vizioni Rinor i Shalës
2.	In Time
3.	Instituti për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë

Neni 2

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontratave të klubeve dhe shoqatave sportive të cekura konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtari përgjegjës Lorik Berbatovci dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

1Nr. 112/02-7522
Lipjan, më 14.02.2025



KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, nenit 23 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATAVE TË KLUBEVE DHE SHOQATAVE SPORTIVE PËRFITUESE TË SUBVENCIONEVE PËR VITIN 2025

Neni 1

Me këtë Vendim, Agim Bylykbashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** Zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratave të klubeve dhe shoqatave sportive përfituese të subvencioneve për vitin 2025 për thirrjen publike Nr.5-453/01-60560 të datës 10.12.2024, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sportë.

Zyrtari përgjegjës do të bëjë monitorimin e zbatimit të kontratave të klubeve dhe shoqatave sportive si vijon :

Nr.	Emërtimi i OJQ-ve (klubeve dhe shoqatave Sportive)
1.	Shoqata e Pedagogëve të sportit shkollor -Lipjan
2.	Klubi Hendbollistik Femrat "Ulpiana" - Lipjan
3.	Shkolla e Futbollit Atletiko - B
4.	Klubi i Hendbollit "Ulpiana" Meshkujt - Lipjan
5.	Klubi i Volejbollit "Ulpiana" Meshkujt - Lipjan
6.	KV "Skenderbeu" Meshkujt
7.	Klubi i Futbollit "Gadimja"
8.	Klubi Voljebollistik "Skenderbeu" -Femrat
9.	Klubi Pingpongut "Ulpiana"
10.	FC "Lipjani 01" - Lipjan
11.	Klubi i Vlojebollit "Ulpiana" Femrat - Lipjan

Neni 2

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontratave të klubeve dhe shoqatave sportive të cekura konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtari përgjegjës Agim Bylykbashi dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

1Nr. 112/02-7520
Lipjan, më 14.02.2025





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligji nr. 08/l-103 për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM

PËR EMËRIMIN E KOORDINATORIT KOMUNAL TË PERFORMANCËS DHE
ZYRTARËVE KOMUNALË PËR PERFORMANCË PËR FUSHAT E CAKTUARA NË
KOMUNËN E LIPJANIT PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË PERFORMANCËS PËR
VITIN 2024

Neni 1 Përbërja

I.Me këtë Vendim, **SHEMSI AZEMI**, në pozicionin e punës Shef i sektorit për tatim në pronë, emërohet **Koordinator Komunal për performancë**, ndërsa **zyrtarë komunalë për performancë për fushat e caktuara** emërohen zyrtarët si vijon:

1. **BURIM GASHI** (fushën e shërbimeve publike administrative)
2. **BUKURIJE ZEJNULLAHU** (fushën e transparences komunale dhe fushën e përgjegjshmërisë komunale)
3. **ALBERT MUSTAFA** (fushën për të drejtat e njeriut, shërbime sociale dhe familjare)
4. **RAMIZ GASHI** (fushën e kulturës, rinisë dhe sportit)
5. **GAFURR HETEMI** (fushën e menaxhimit të fatkeqësive)
6. **HANUSHE BERISHA** (fushën e planifikimit hapësinor komunal, fushën e hapësirave publike komunale dhe fushën e mbrojtjes së mjedisit)
7. **FATBARDHA SHURDHIQI** (fushën e infrastrukturës rrugore lokale, fushën e furnizimit me ujë të pijshëm, fushën e kanalizimit dhe higjienës publike dhe fushën e menaxhimit të mbeturinave)
8. **SALIHE MAREVCI** (fushën e transportit publik komunal dhe fushën e hapësirave për parkim publik)
9. **HASAN LUMA** (fushën e përfaqësimit gjinor)
10. **BRAHIM DURIQI** (fushën e arsimit parauniversitar)
11. **IZER SINANI** (fushën e kujdesit primar shëndetësor)
12. **LINDA SHAHINI** (fushën e integritetit dhe zhvillimit)

II. Kordinatori dhe zyrtarët komunalë për performance i kanë të përshkruara në mënyrë të përgjithshme detyrat e punës në nenet vijuese 2 dhe 3 ndërsa me këtë Vendim obligohen të hartojnë raportin e performancës vetëm për vitin 2024 me mundësi vazhdimi

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Kordinatorit Komunal për Performancë

Detyrat dhe përgjegjësitë e Kordinatorit komunal për performancë janë:

- Bashkërendon punën e përgjithshme në Komunë për administrimin e sistemit për matjen e performancës,
- Propozon listën e zyrtarëve komunal për performancë(zyrtarëve përgjegjës) për miratim nga kryetari i Komunës dhe udhëheqë punën e tyre në procesin e mbledhjes, verifikimit dhe raportimit të të dhënave (MVRDH),
- Harton planin e veprimit dhe organizon takime pune me zyrtarët komunal të performancës (ZKP) për metodologjinë e zbatimit të tij për MVRDH në sistem,
- Monitoron procesin e MVRDH në sistem dhe jep udhëzime profesionale ZKP gjatë MVRDH sipas nevojë,
- Bashkërendon punën sipas, nevojë, me drejtoritë përkatëse nëpërmjet drejtorit të administratës,
- Bën verifikimin e të dhënave të raportuara nga ZKP sipas një orari përkatës gjatë tërë vitit të raportimit dhe deri me 14 shkurt të vitit vijues.
- Përgatitë të dhënat e verifikuara dhe i dërgon për miratim tek kryetari i komunës nëpërmjet drejtorit të administratës deri me 21 janar të vitit vijues për vitin përkatës të raportimit. Në të njëjtën kohë bën verifikimin e të dhënave, nëpërmjet ZKP, nëse kryetari kërkon për shkak të dyshimeve eventuale në saktësinë e tyre,
- Sipas nevojë, bën raportimin e të dhënave të miratuara nga kryetari kur kjo nuk bëhet automatikisht nëpërmjet sistemit,
- Bën arkivimin e të dhënave të miratuara nga kryetari i komunës në kopje fizike në arkivën e komunës apo në arkivën zyrtare të KKP. Një kopje e miratuar nga kryetari i komunës i të dhënave arkivohet në mënyrë automatike nga programi elektronik në bazën e të dhënave në kompjuterin e KKP, të kryetarit të kryetarit të komunës dhe në MAPL- zyrtari përgjegjës për menaxhimin e të dhënave në DPK.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit komunal për performancë

Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit komunal për performancë janë:

- Harton planin për mbledhjen, verifikimin dhe raportimin e të dhënave për fushën përkatëse i ngarkuar nga kryetari i komunës , mbi bazën e kërkesave të KKP.
- Mbledhë, verifikon dhe raporton apo futë të dhëna në sistem gjatë tërë vitit të raportimit dhe deri me 20 janar të vitit vijues.
- Kujdeset që para futjes së të dhënave në sitem, ta verifikojë saktësinë e të dhënës duke u bazuar vetëm në burimin zyrtarë të të dhënave përkatëse dhe bazuar në dokumente përfundimtare zyrtare, që d.m.th në dokumente të miratuara nga organet përgjegjëse të komunës, të protokoluara dhe me datën përkatëse të protokollimit apo të miratimit, varësisht nga lloji i dokumentit zyrtar.

- Bashkërendon dhe bashkëpunon me përgjegjësitë e njësive përkatëse ku punon dhe prej ku i merr të dhënat dhe me KKP.
- Raporton të dhënat e verifikuara tek KKP, në kopje fizike, kur kjo nuk bëhet në mënyrë automatike nga program elektronik i SMPK. Është përgjegjësi kryesor për saktësinë e të dhënave të raportuara në komunë për SMPK.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet MAPL, Koordinatori komunal për performancë dhe zyrtarët komunal për performancë të cekur më lartë.

1Nr. 016/01-6055
Lipjan, më 05.02.2025

KRYETARLI KOMUNËS





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

**VENDIM
PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES**

**Neni 1
Përbërja**

Me këtë Vendim, formohet grupi punues për hartimin e Draft – Planit për strehim familjar në Komunën e Lipjanit , në përbërje si vijon:

1. Shkelzen Hajdini-Drejtor i DSHPS, Kryesues
2. Makfirete Shamolli-Drejtoreshë e QPS-së, anëtare
3. Lorik Berbatovci- Udhëheqës i Sektorit për Kulturë, anëtar
4. Fjolla Ibrahim - Zyrtare e Sherbimeve sociale QPS, anëtare
5. Hyrije Qerkini- Zyrtare e Sherbimeve sociale QPS, anëtare
6. Sevdije Syleviq- Zyrtare e Sherbimeve sociale QPS, anëtare
7. Suzana Mehmeti -Blakqori- Zyrtare e Sherbimeve sociale QPS, anëtare
8. Xheneta Isufi-Mollopolci- Zyrtare e lartë për Mirëqenie Sociale QPS. anëtare
9. Zyrafete Mavriqi-Zyrtare për Mirëqenie Sociale QPS, anëtare
10. Qefsere Sllamniku-Zyrtare për Mirëqenie Sociale QPS, anëtare
11. Brahim Duriq –DKA, anëtar
12. Luljeta Reqica – QKMF, anëtare
13. Kimete Ratkoceri- QKMF. anëtare

Neni 2

Detyrat e grupit punues

1. Grupi punues ka për detyrë të bëjë hartimin e dokumentit – Draft -Planit për strehim familjar në Komunën e Lipjanit të më së largu deri më 15.03.2025.
2. Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e konsultimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse dhe të mbajë takim publik të hapur duke mbajtur procesverbal në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjës për konsultime publike të Komunës së Lipjanit.

Neni 3

Hryja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet kryesuesi dhe anëtarët e grupit punues.

1Nr. 020/04-7723
Lipjan, më 18.02.2025





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

**VENDIM
PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES**

Neni 1

Përbërja

Me këtë Vendim, formohet grupi punues për hartimin e Draft – Strategjisë lokale të veprimit rinor 2025-2030 dhe Draft- Planin e veprimit rinor lokal 2025-2027, në përbërje si vijon:

1. Anila Reçica, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesuese,
2. Bekim Zaskoku, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport , anëtar
3. Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar,
4. Pranvera Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport anëtare
5. Hasan Luma , NJDNJ dhe barazi gjinore, anëtar,
6. Suzana Mehmeti , Qendra për punë sociale , anëtare
7. Valdete Muji, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtare
8. Abedin Bajrami, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtar
9. Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim, anëtar,
10. Arbëresha Hetemi, Zyra Lokale për Komunitete, anëtare
11. Albulena Salihu, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
12. Bekim Krasniqi, OJQ " YAHR" anëtar
13. Afrim Mena , OJQ " Handikos" anëtar
14. Florim Budakova, Shoqata e pedagogëve të sportit shkollor, anëtar

Neni 2

Detyrat e grupit punues

1. Grupi punues ka për detyrë të bëjë hartimin e dokumentit të Draft – Strategjisë lokale të veprimit rinor 2025-2030 dhe Draft- Planin e veprimit rinor lokal 2025-2027, duke u bazuar në dispozitat përkatëse ligjore në fuqi më së largu deri më 15.03.2025.
2. Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e konsultimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse dhe të mbajë takim publik të hapur duke mbajtur procesverbal në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjës për konsultime publike të Komunës së Lipjanit.

Neni 3

Hryja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet kryesuesi dhe anëtarët e grupit punues.

1Nr. 020/04-5656
Lipjan, më 03.02.2025

KRYETARI I KOMUNES

Imri Ahmet





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

VENDIM
PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIFIKIMIT TË
PROJEKT BUXHETIT 2026-2028

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim themelohet grupi punues për hartimin e planifikimit të projekt buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026-2028, në përbërje si vijon:

1. Latif Ramadani, Drejtor në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, Kryesues
2. Visar Kozhani, Zyrtar në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, anëtar,
3. Alban Bytyqi, Zyrtar financiar në QKMF, anëtar,
4. Ismet Haziri, Zyrtar në Drejtoratin për Arsim, anëtar dhe
5. Ferdian Shala, Zyrtar në Zyren e Kryetarit të Komunës, anëtar.

Neni 2
Detyrat e Grupit Punues

Grupi punues ka për detyrë hartimin e projekt planifikimit të buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026-2028 si dhe organizimin e degjimeve buxhetore në Komunën e Lipjanit. Grupi punues bëne vlerësimin e kërkesave të pranuar nga qytetarët dhe vendos cilat kërkesa pranohen dhe cilat refuzohen. Grupi punues duhet të hartojë planin e punës dhe të caktoj orarin e mbajtjes së degjimeve buxhetore duke mbajtur procesverbal dhe duke hartuar raport të punës së kryer të gjitha detyrat e hartimit të planifikimit të buxhetit për vitin 2026-2028 dhe organizimin e degjimeve buxhetore do të bëjë konform dispozitave të parapara ligjore që janë në fuqi. Po ashtu në fund të hartojë raportin nga degjimet buxhetore për ta dërguar në Kuvendin e Komunës. Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e degjimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse në fuqi në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjës për konsultime publike të Komunës së Lipjanit.

Neni 3
Hryja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 020/04-8994
Lipjan, më 26.02.2025

KRYETARI KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 14 Rregullorës për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022, Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave për student të Komunës së Lipjanit Nr.15-670/01-22599 të datës 28.04.2023 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE PËR BURSAT E STUDENTEVE

Neni 1

Përbërja

Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të studenteve të cilët janë ankuar ndaj listës preliminare të shpallur nga Komisioni vlerësues për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit për vitin akademik 2024/2025, Nr.4-670/01-8536 datë 24.02.2025, në këtë përbërje:

1. Islam Kaleshi, Zyrtar Ligjor në Sektorin për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore, Kryesues
2. Fatbardha Shurdhiqi, Zyrtare në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, anëtare
3. Albulena Salihu, Zyrtare në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, anëtare

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit

1. Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi të bëjë shqyrtimin e ankesave të studenteve të cilët janë ankuar ndaj listës preliminare Nr.4-670/01-8536 datë 24.02.2025 të shpallur nga Komisioni vlerësues për ndarjen e bursave për studentë të komunës së Lipjanit për vitin akademik 2024/2025. Komisioni do të shqyrtoj ankesat në bazë dispozitave të Rregullorës për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022, Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave për student të Komunës së Lipjanit Nr.15-670/01-22599 të datës 28.04.2023 si dhe kriterve të konkursit për ndarjen e bursave Nr.4-670/01-62802 të datës 24.12.2024.
2. Punët teknike administrative për Komisionin do të kryhen nga Drejtorati për Arsim.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe më të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Arsim, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-8698
Lipjan, më 24.02.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmet





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, si dhe Rregullores për Transparencën në Komunën e Lipjanit 15Nr.-016/01-63314 e datës 26.12.2024, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR DRAFT – STATUTIN E QENDRËS PËR PUNË SOCIALE NË LIPJAN

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Draft –Statuti i Qendrës për Punë Sociale në Lipjan.

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet për Draft – Statutin e Qendrës për punë Sociale mund ti dërgohen Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ose në email adresën shkelzen.hajdini@rks-gov.net, më së largu me datë 14.03.2025.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës.

1Nr. -020/01-9264
Lipjan, më 27.02.2025

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmesi





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Na osnovu članova 13, 58 i 68 stav 68.4 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br.03/L-040, Službena Novina Republike Kosova, br.28 dt. 4 juni 2008, članova 40, 41 i 67 Statuta Opštine Lipljan 15Br.110-78095 dt. 24.12.2021, Administrativno Upustva (MUP) Br.04/2023 za u pravu open u open u opštini, Uredba o Transparentnosti u Opštini Lipljan, Br. 15-016/01-63314 dt.26.12.2024, Predsednik Opštine donosi:

ODLUKA
O JAVNOJ KONSULTACIJI ZA PROJEKT-STATUT CENTRA ZA SOCIJALNI RAD
LIPJAN

Član 1

U cilju sprovođenja konsultacija i učešća javnosti, u usvajanju akata iz nadležnosti Opštine, objaviti na Websajt Opštine:

Projekt -.Statut Centra za Socijalni Rad i Lipjan

Član 2

Primedbe i sugestije na ovaj Projekt – Statut Centra za Socijalni Rad i Lipjan mogu se poslati Direkcije za Zdravstvenu i Socijalnu Zaštitu na email adresu: shkelzen.hajdini@rks-gov.net naj kasnije do 14.03.2025.

Član 3

Ova Odluka stupa na snagu danom usvajanja i biće objavljena na Websajt Opštine.

1Br. 020/01-9264
Lipljan, 27.02.2023

PREDSEDNIK OPŠTINE
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues për shpalljen e përfituesve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të (klube dhe shoqatat sportive) Nr.5-453/01-5408 të datës 31.01.2025, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR OJQ - TË (KLUBET DHE SHOQATAT SPORTIVE) PËR VITIN 2025

Neni 1

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 27,290.00 € (njëzet e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë euro), për t'i mbështetur financiarisht OJQ-të (klubet dhe shoqatat sportive) të Komunës së Lipjanit për zhvillimin e aktiviteteve të tyre për vitin 2025, të cilët kanë aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.5-453/01-60560 të datës 10.12.2024, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sportë.

2. Në tabelën vijuese janë OJQ-të (klubet dhe shoqatat sportive) përfituese të cilat do të mbështeten financiarisht nga Komuna për vitin 2025:

Nr.	Emërtimi i OJQ-ve (klubet dhe shoqatat sportive)	Shuma
1.	Shoqata e Pedagogëve të sportit shkollor -Lipjan	2,800.00 €
2.	Klubi Hendbollistik Femrat "Ulpiana" - Lipjan	2,000.00 €
3.	Shkolla e Futbollit Atletiko - B	3,000.00 €
4.	Klubi i Hendbollit "Ulpiana" Meshkujt - Lipjan	2,000.00 €
5.	Klubi i Volejbollit "Ulpiana" Meshkujt - Lipjan	2,500.00 €
6.	KV "Skenderbeu" Meshkujt	2,500.00 €
7.	Klubi i Futbollit "Gadimja"	3,000.00 €
8.	Klubi Voljebollistik "Skenderbeu" -Femrat	2,490.00 €
9.	Klubi Pingpongut "Ulpiana"	1,500.00 €
10.	FC "Lipjani 01" - Lipjan	3,000.00 €
11.	Klubi i Vlojebollit "Ulpiana" Femrat - Lipjan	2,500.00 €
	Shuma Totale	27,290.00 €

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2025 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe klubeve dhe shoqatave sportive do të rregullohen në kontratat të cilat do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe secilit klub ose shoqate sportive veq e veq.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr.453/01-4508/2

Lipjan, më 03.02.2025





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues për shpalljen e përfituesve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të Nr.5-453/01-5535 të datës 03.02.2025, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR OJQ - TË PËR VITIN 2025

Neni 1

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **11,985.00 €** (njëmbëdhjet mijë e nëntëqind e tetëdhejtë e pesë euro), për t'i mbështetur financiarisht OJQ-të të Komunës së Lipjanit për zhvillimin e aktiviteteve të tyre për vitin 2025, të cilët kanë aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.5-453/01-60170 të datës 06.12.2024, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sportë.

2. Në tabelën vijuese janë OJQ-të përfituese të cilat do të mbështeten financiarisht nga Komuna për vitin 2025:

Nr.	Emërtimi i OJQ-ve	Shuma
1.	Vizioni Rinor i Shalës	4,000.00 €
2.	In Time	3,985.00 €
3.	Instituti për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë	4,000.00 €
	Shuma Totale	11,985.00 €

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2025 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe OJQ-ve do të rregullohen në kontratat të cilat do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe seciles OJQ veq e veq.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr.453/01-5535/2
Lipjan, më 04.02.2025





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës, nxjerr:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **10,640.00€**, (dhjetë mijë e gjashtëqind e katërdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-5795 të datës 04.02.2025, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 38 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin janar të vitit 2025 me nga 280 euro për secilin rast $38 \times 280 = 10,640.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2025, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryeatrit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB .

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame e Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-5795
Lipjan, më 05.02.2025





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 duke u bazuar në Marrëveshjen për Shërbime të Energjisë e datës 30.12.2024, lidhur në mes të Komunës së Lipjanit përfaqësuar nga Kryetari i Komunës Z. Imri Ahmeti dhe Organizatës Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë përfaqësuar nga Drejtori Menaxhues Z. Driton Hetemi, Kryetari i Komunes, nxjerr:

**VENDIM
PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE**

I. Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve më vlerë prej 7.075.86 € (shtatë mijë e shtatëdhjetë e pesë euro e tetëdhjetë e gjashtë cent), konform dispozitave të Marrëveshjen për Shërbime të Energjisë e datës 30.12.2024, lidhur në mes të Komunës së Lipjanit, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës Z. Imri Ahmeti dhe Organizatës Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë përfaqësuar nga Drejtori Menaxhues Z. Driton Hetemi për projektin të zbatimit të masave të Eficiencës së Energjisë në ndërtesën "Shtjefën Gjeqovi" në Janjevë .

II. Shuma e cekur në pikën I të këtij Vendimi transferohet me qëllim të përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes për Shërbime të Energjisë e datës 30.12.2024, e cila paguhet në emër të tarifës për menaxhimin e projektit prej 2% të shumës së investimit të përgjithshëm.

III.Shuma e cekur nga neni I do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2025, Fondi për bashkëfinancim me donatorë në xhirollogarinë bankare të Organizatës Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë me nr. 1708020600000153 në NLB Banka.

IV.Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Infrastrukturë dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

INr. 400/01-7525
Lipjan, më 14.02.2025





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 duke u bazuar në Marrëveshjen e Bashkëfinancimit të datës 12.11.2024 dhe dhe Amandamentit të Marrëveshjes së datës 23.12.2024, lidhur në mes të Komunës së Lipjanit përfaqësuar nga Kryetari i Komunës Z. Imri Ahmeti dhe Organizatës Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë përfaqësuar nga Drejtori Menaxhues Z. Driton Hetemi, Kryetari i Komunes, nxjerr:

VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

I. Me këtë Vendim, TRANSFEROHET, shuma e mjeteve më vlerë prej 12.126.30 € (dymbëdhjetë mijë e njëqind e njëzet e gjashtë euro e tridhjetë cent), konform dispozitave të Marrëveshjes së Bashkëfinancimit të datës 12.11.2024 dhe Amandamentit të Marrëveshjes së datës 23.12.2024, lidhur në mes të Komunës së Lipjanit, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës Z. Imri Ahmeti dhe Organizatës Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë përfaqësuar nga Drejtori Menaxhues Z. Driton Hetemi për projektin të zbatimit të masave të Eficiencës së Energjisë në ndërtesën shumë-banesore sociale në Magure .

II. Shuma e përgjithshme e sipas Marrëveshjes së Bashkëfinancimit të datës 12.11.2024, lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë për projektin të zbatimit të masave të Eficiencës së Energjisë në ndërtesën shumë-banesore sociale në Magure është në vlerë prej 233,530.00 € përkatësisht vlera e financimit nga FKEE është 90% apo 210,177.00 € dhe vlera e financimit nga Komuna e Lipjanit është 10% apo 23,353.00€. Pjesa e parë e vlerës së bashkëfinancimit në shumë prej 11.226.70 € (njëmbëdhjetë mijë e dyqind e njëzet e gjashtë euro e shtatëdhjetë cent) është transferuar nga Komuna në vitin paraprak.

III.Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2025, Fondi për bashkëfinancim me donatorë në xhirollogarinë bankare të Organizatës Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë me nr.1110350980010125 në Procredit Bank.

IV.Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Infrastrukturë dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

INr. 400/01-7528
Lipjan, më 14.02.2025

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti